



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2019 merr këtë

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E LAPIDARIT KUSHTUAR
TË VRARËVE PRISHTINAS NË PESËVJEÇARIN E PARË PAS LUFTËS SË DYTË
BOTËRORE

- I. **MIRATOHET** Vendimi për vendosjen e lapidarit kushtuar banorëve të Prishtinës me rrethinë, të vrarë nga regjimi i atëhershëm në pesëvjeçarin e parë pas Luftës së Dytë Botërore, për veprimtari të çështjes kombëtare, në vendin që nga prishtinasit njihet si "Strelishte" – afër parkut të sotëm Taukbahçe në Prishtinë.
- II. Lokacioni për vendosjen e lapidarit kushtuar të vrarëve pas Luftës së Dytë Botërore, shtrihet në zonën mes rrugëve "1 Tetori" dhe "Dëshmorët e Marecit", përkatësisht në pjesën e parcelës kadastrale nr. 2550-0, ZK Prishtinë, në pronësi - Pronë shoqërore, KK Prishtinë.
- III. Ky vendim paraqet bazë për lejimin e vendosjes së lapidarit përkujtimor.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Pamja nga "Google Earth", ortofoto e lokacionit dhe propozimideja për dukjen e këtij lapidari.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/01-0073683/19, më 29.03.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



ARSYETIM

i Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të vrarëve prishtinas në pesëvjeçarin e parë pas Luftës së Dytë Botërore

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka shqyrtuar kërkesën elektronike, të dt. 05.03.2019, nga Grupi Parlamentar AKR dhe Alternativa, për caktimin e një lokacioni për vendosjen e një lapidari. Kjo kërkesë është adresuar edhe në Kuvendin e kryeqyteti dhe është mbështetur edhe nga kryetari i kryeqytetit.

Bazuar në përmbajtjen e kësaj kërkesë, në vendin që nga prishtinasit njihet si “Strelishte”, që ndodhet afër parkut të sotëm Taukbahçe në Prishtinë, pushteti komunist i asaj kohe torturoi dhe pushkatoi atdhetarë antikomunistë, pjesëtarë të aristokracisë prishtinase, klerikë myslimanë e katolikë, pronarë dyqanesh e biznesesh etj. Sipas dëshmimeve të kohës së ngjarjes dhe sipas historianëve vendorë, numri i përgjithshëm i të pushkatuarve mund të arrijë deri në 3750 persona. Pjesa më e madhe e tyre u pushkatuan dhe u varrosën pa gjykim, pa rituale fetare dhe pa praninë e familjarëve.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartcekur, në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie, ka identifikuar lokacionin për vendosjen e Lapidarit kushtuar të vrarëve prishtinas në dy dekada pas Luftës së Dytë Botërore, i cili gjendet në kuadër të Planit rregullues të hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 031-247790, të dt. 04.10.2016, sipas të cilit kjo zonë është paraparë për gjelbërim dhe zonë ku kalojnë largpërçuesit.


Lokacioni i propozuar shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale nr. 2550-0, ZK Prishtinë, në pronësi - Pronë shoqërore, KK Prishtinë.

Vendosja e lapidarit në fjalë është propozuar të bëhet në zonën mes rrugëve “1 Tetori” dhe “Dëshmorët e Marecit” në Prishtinë, me një pamje imponante, andaj në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për caktimin e lokacionit sipas kërkesës së lartcekur.


Bazuar në gjendjen faktike, konstatohet se hapësira ku do të vendoset lapidari është sipërfaqe e gjelbëruar, andaj gjatë vendosjes së tij duhet t’i kushtohet kujdes i veçantë ambientit dhe rregullimit të parterit. Sa i përket madhësisë, formës dhe materialit, është përcaktuar vetëm si propozimide, e cila më pastaj do të përpunohet.

Bashkëngjitur:

- Pamje nga “Google Earth”,
- Ortofoto e lokacionit,
- Propozimideja.



Pamje nga Google Earth



Ortofoto e lokacionit



Propozim-ide për dukjen e lapidarit